



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:296530

Datë: 26.02.2021

Numri i dokumentit: 01546248

C.nr. 700/2019

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini me bashkëpunëtorin profesional Adnan Hajdari, në çështjen kontestimore të paditëses, N.N nga fshati Pozheran, Komuna e Vitisë, të cilën me autorizim e përfaqëson, Malsore Halili, avokate nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Vitisë -DKA, të cilën me autorizim e përfaqëson, Ekrem Shabani, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar, shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit, vlera e objektit të kontestit 2, 204.25 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 18.02.2021, jashtë seance, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.N nga fshati Pozheran, Komuna e Vitisë, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Vitisë - DKA dhe, detyrohet e paditura që paditëses, në emër të shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës, t'ia kompensoj shumën prej 344.25 Euro, ndërsa, në emër të ushqimit ditorë për 689 ditë pune, për periudhën 18.04.2017 deri më 16.02.2021, t'ia kompensoj shumën prej 1, 378 Euro, dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit, në relacionin fshati Pozheran - Viti dhe ansjelltas, për 689 ditë pune, t'ia kompensoj shumën prej 482.30 Euro, të gjitha këto në shumë prej 2, 204.25 Euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

II. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270 Euro.

A r s y e t i m

Paditësja N.N, përmes përfaqësueses së saj me autorizim, me padinë e datës 24.12.2019 dhe parashtresës mbi precizimin e padisë të datës 18.02.2021, e gjithashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga Gjykata, t'ia aprovojë kërkesëpadinë për kompensimin e shpërblimit jubilar për 20 vite të përvojës së punës, në shumë prej 344.25 Euro, shpenzimet e ushqimit ditorë nga 2 Euro në ditë, për 689 ditë pune, të llogaritur nga data 18.04.2017 deri më 16.02.2021, në shumë prej 1, 378 Euro, si dhe shpenzimet e udhëtimit në relacionin nga fshati Pozheran, për në vendin e punës në Viti, 70% të biletës së trafikut urban nga 1 Euro në ditë, për 689 ditë pune, shumën prej 482.30 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive me datë 18.04.2017 e deri në pagesën definitive.

Bazën ligjore për kërkesën e saj, paditësja e mbështeti në nenin 35, par.5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, për shkak se është në marrëdhënie pune në SHMP "Jonuz Zejnullahu" në Viti, dhe përkundër kërkesës para fillimit të procesit kontestimor, e paditura nuk ia ka kompensuar paditëses shpërblimin jubilar, shpenzimet e udhëtimit dhe

ushqimit ditorë, të cilat i takojnë sipas kontratës kolektive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar: për përpilim të padisë shumë prej 104 Euro, për precizim të padisë shumë prej 80 Euro, për kërkesën në procedurë administrative shumë prej 80 Euro për një seancë të mbajtur gjyqësore shumë prej 135 Euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 31 Euro.

E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke e cilësuar si të pa bazë ligjore për faktin se DKA-Komuna e Vitisë nuk është përgjegjëse për moszbatimin e kontratës kolektive të vitit 2017, të cilën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe SBASHK, dhe nuk kanë ndarë mjete buxhetore për kompensimin e këtyre beneficioneve që dalin nga Kontrata Kolektive, andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Vendimi i SHMP “Jonuz Zejnullahu” me nr.prot.57, i datës 16.02.2021, Vërtetimi mbi përvojën e punës me nr.prot.57/1, i datës 16.02.2021, Lista e pagave e muajit janar 2021, Certifikata e vendbanimit me nr.V10288116, e lëshuar me datë 28.10.2020, Vërtetimi i Kompanive të Transportit, Vërtetimi me nr.prot.316, i datës 18.12.2019, Kërkesa drejtuar DKA-së me nr.05-320/04-59232, e datës 25.11.2019.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses N.N është e bazuar, dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Nga provat materiale të administruara gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike; Paditësja N.N nga fshati Pozheran, është në marrëdhënie pune te e paditura nga data 01.09.2001, dhe ka gjithsej 28 vite të përvojës së punës, ndërsa për realizimin e kërkesës së saj për shpërbllimin jubilar, shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimin, para fillimit të procedurës gjyqësore, i është drejtuar fillimisht të paditurës me kërkesën e datës 25.1.2019 të cilës kërkesë e paditura i ishte përgjigjur negativisht.

Faktin se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, gjykata e vërtetoi në bazë të Vërtetimit me nr.prot.57/1, i datës 16.02.2021, të lëshuar nga SHMP “Jonuz Zejnullahu” në Viti, sipas të cilit, paditësja kishte themeluar marrëdhënie të punës në këtë institucion nga data 01.09.2001 dhe ende vazhdon të punoj. Paga bazë e paditëses prej 459 Euro, u vërtetua në bazë të Listës së pagave, sipas të cilës paditësja është anëtare e SBASHK-ut dhe për këtë paguan anëtarësi. Ndërsa, përvoja e punës prej 28 vite u vërtetua në bazë të Vendimit me nr.prot.57, i datës 16.02.2021, të lëshuar nga Drejtori i kësaj shkolle, kurse fakti se paditësja për periudhën 18.04.2017 deri më 16.02.2021 ka qenë e pranishme në punë 689 ditë u vërtetua me Vërtetimin me nr.prot.57/1, i datës 16.02.2021.

Faktin se paditësja udhëton me transport të udhëtarëve nga vendbanimi i saj në fshatin Pozheran deri në vendin e saj të punës në Viti, gjykata e vërtetoi në bazë të Vërtetimit të lëshuar nga Kompanitë e Transportit të udhëtarëve, të cilat operojnë në Komunën e Vitisë, i cili vërtetim në Anex-1 përmban çmimorën e biletave të udhëtimit, në vendbanimet brenda Vitisë, sipas të cilit çmimi i biletës në relacionit Pozheran – Viti dhe anasjelltas është 1 euro.

Meqenëse në bazë të provave të administruara u vërtetua gjendja faktike si më lart, gjykata e obligoi të paditurën që paditëses, në emër të shpërbllimit jubilar t’ia paguaj 75% të pagës bazë në shumë prej 344.25 Euro, në emër të ushqimit për 689 ditë pune, t’ia kompensojë

shumën prej 1,378.00 Euro si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit të 70% të biletës prej 1 Euro, për 689 ditë pune, shumën prej 482.30 Euro.

Me rastin e vendosjes për kompensimin e ushqimit, Gjykata u bazua në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, i cili ka paraparë kompensimin e ushqimit në punë nga 2 Euro për një ditë pune. Me rastin e vendosjes për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, gjykata u bazua në nenin 35 pika 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, i cili ka paraparë kompensimin e udhëtimit prej 70% të biletës së trafikut urban, për punëtorët e arsimit të cilët udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse, ndërsa për shpërblimin jubilar gjykata u bazuar në nenin 35 par. 8, pika 8.2 të Kontratës Kolektive, i cili ka paraparë “punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: [...] për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë [...]”.

Sa i përket periudhës së kërkesës së paditëses pas datës 18.04.2020 deri me 16.02.2021, gjykata konsideron se kontrata kolektive zbatohet edhe për këtë periudhë për shkak se sipas nenit 45 “[...] nëse nga kontrata kolektive pasi t’i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit [...]”. Kontrata Kolektive ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa nuk ka dëshmi se ndonjëra nga palët kontraktuese është tërhequr.

Gjykata, me qëllim të zbatimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, nuk caktoi ekspert financiar për faktin se e paditura nuk pati vërejtje në provat e administruara, andaj, llogaritja e shumave është bërë sipas përlllogaritjes së thjesht matematikore, pasi edhe nuk u kundërshtua nga palët dhe për gjykatën ishte e qartë si kërkesa ashtu edhe shumata e kërkuar.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës, të cilat u gjetën si të pa bazuara, për shkak se palët kontraktuese të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2 të kësaj Kontrate kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Për më tepër, nenin 37 kanë përcaktuar se “palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”. Andaj, sipas dispozitave të këtyre neneve, e paditura është e lidhur me detyrimet që burojnë nga kjo kontratë, sepse, për gjykatën nuk ka rëndësi pretendimi që e paditura nuk ka linjë të veçantë buxhetore për kompensimin e këtyre kërkesave.

Lidhur me kamatën gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së, i cili përcakton se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debitorin, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Gjykata nuk e aprovoi kërkesën që kamata të llogaritet nga data e hyrjes në fuqi e Kontratës Kolektive, për shkak se, përfaqësuesja e paditëses, nuk e saktësoi se prej cilës datë këto kërkesa kanë arritur për pagesë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, pasi që e paditura e ka humbur kontestin në këtë rast, andaj edhe obligoi të njëjtën që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270 Euro edhe atë: për

përpilimin e padisë 104 Euro, për taksë gjyqësore 31 Euro si dhe për një seancë gjyqësore 135 Euro, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifat e Avokatëve të Kosovës. Ndërsa, kompensimin e shumës prej 80 Euro për kërkesën e përpiluar në procedurë administrative, si dhe për precizim të padisë shumë prej 80 Euro, gjykata nuk i aprovoi, për shkak se kompensimi i kërkesës në procedurë administrative nuk hyn në shpenzimet e procedurës gjyqësore ashtu siç është përcaktuar në nenin 449.1 të LPK-së. Sa i përket kompensimit për parashtresën – saktësimin e kërkesave, ka qenë obligim që të bëhet fillimisht me paraqitjen e padisë në gjykatë. Duke pasur parasysh se çështja është jo komplekse, gjykata ka vendosur që të kompensohen vetëm shpenzimet e nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq, ashtu siç përcaktohet në nenin 453.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr. 700/2019, datë 18.02.2021

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.